



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 7

Tiranë – E premte, 26 janar 2018

PËRMBAJTJA

Udhëzim i ministrit të Financave
dhe Ekonomisë nr. 3, datë 23.1.2018

Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore.....

Faqe

141



UDHËZIM

Nr. 3, datë 23.1.2018

PËR VLERËSIMIN E MALLRAVE PËR
QËLLIME DOGANORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe bazuar në pikat 4 dhe 5, të nenit 161, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, me qëllim lehtësimin dhe zbatimin praktik nga administrata doganore të procedurës dhe metodologjisë së vlerësimit të mallrave për qëllime doganore, Ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

1. Parime të përgjithshme

Në zbatim të ligjit nr. 102/2014, të ndryshuar (në vijim Kodi Doganor), vlera doganore bazohet në parimet e Marrëveshjes së Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) për Vlerësimin Doganor (“Marrëveshja”, neni VII), që përcakton rregullat e vlerësimit, duke unifikuar metodologjinë, evituar pabarazinë dhe arbitraritetin përmes një procesi të drejtë dhe të paanshëm.

2. Vlerësimi doganor

Vlerësimi doganor është procedura për përcaktimin e vlerës së mallrave dhe shërbimeve që lidhen me to, për qëllime doganore. Vlera doganore e mallrave është e domosdoshme për të përlloritur shumën e detyrimeve doganore *ad-valorem*, që duhet të paguhen për mallrat e importuara.

3. Shqyrtimi i vlerës doganore

Procedura për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave nis me shqyrtimin e dokumentacionit shoqërues dhe, kur është e nevojshme, kërkohen sqarime dhe dokumentacion plotësues. Megjithatë, shqyrtimi i vlerës doganore nuk do të konsiderohet si “moment”, por si një “proces”, që fillon me marrjen dhe shqyrtimin e informacionit paraprak (kur kjo është e mundur), deri në kontrollet pas zhdoganimit.

4. Metodatat e vlerësimit doganor

Ka gjashtë metoda për llogaritjen e vlerës së mallrave për qëllime doganore. Metoda bazë e vlerësimit është metoda 1, “Vlera e transaksionit”.

Kur vlera doganore e mallrave nuk mund të përcaktohet sipas metodës 1, “Vlera e transaksionit”, ajo përcaktohet me një nga metodat pasardhëse, duke ndjekur rendin rritës dhe zbatuar metodën më të parë, për të cilën ka të dhëna të nevojshme për vlerësimin e mallrave.

4.1 Metoda 1, “Vlera e transaksionit”

4.1.1. Baza kryesore për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave është vlera e transaksionit, që është çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar për mallrat e shitura për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke marrë në konsideratë edhe rregullimet, kur është e nevojshme.

4.1.2. Çmimi realisht i paguar apo që duhet paguar është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi të shitësi ose nga blerësi tek një palë e tretë në përfitim të shitësit për mallrat e importuara dhe përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë si kusht për shitjen e mallrave të importuara.

4.1.3. Një transaksion duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Nuk ka asnjë kufizim për tjetërsimin/shkatërrimin ose përdorimin e mallrave nga blerësi, përveç kufizimeve:

i) të vëna ose të kërkuara me ligj, ose nga autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë;

ii) të zonës gjeografike, në të cilën mallrat mund të rishiten;

iii) të cilat nuk ndikojnë në mënyrë thelbësore në vlerën doganore të mallrave.

b) Shitja ose çmimi nuk janë objekt i ndonjë kushti ose kërkese, për shkak se të cilave nuk mund të përcaktohet vlera doganore e mallrave që duhen vlerësuar.

c) Asnjë pjesë e të ardhurave të çdo rishitjeje, tjetërsimi ose përdorimi të mëvonshëm të mallrave nga blerësi të mos i kthehet drejtpërdrejt ose tërthorazi shitësit, përveç rastit kur mund të bëhet një rregullim i duhur.

d) Blerësi dhe shitësi nuk janë të lidhur ose kur lidhja nuk ndikon në çmim.

4. 2 Metoda 2, “Vlera e transaksionit të mallrave identike”

Vlera doganore është e bazuar në vlerën e transaksionit të mallrave identike, shitur për eksport në Republikën e Shqipërisë dhe të eksportuara në ose afërsisht të njëjtën kohë si mallrat që po vlerësohen, për të cilat është



pranuar më parë transaksioni (Metoda 1).

4.3 Metoda 3, “Vlera e transaksionit e mallrave të ngjashme”

Vlera doganore është e bazuar në vlerën e transaksionit të mallrave të ngjashme të shitura për eksport në Republikën e Shqipërisë dhe të eksportuara në ose afërsisht të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen, për të cilat më parë është pranuar transaksioni (Metoda 1).

4.4 Metoda 4, “Metoda deduktive”

Vlera doganore është e bazuar në çmimin e shitjes për njësi për sasinë më të madhe në të cilën mallrat e importuara identike ose të ngjashme u janë shitur personave që nuk kanë lidhje me shitësit.

4.5 Metoda 5, “Vlera e llogaritur”

Vlera doganore bazohet në shumën e:

a) koston e materialeve dhe prodhimit apo përpunimeve të tjera, të përfshira në prodhimin e mallrave të importuara;

b) fitimi dhe shpenzimet e përgjithshme;

c) kostot e transportit, të sigurimit, të shpenzimeve të ngarkimit dhe të trajtimit që lidhen me transportin e mallrave të importuara.

4.6 Metoda 6, “Të dhënat e disponueshme”

Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas metodave të mësipërme, ajo përcaktohet në bazë të të dhënave të disponueshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, duke përdorur mjete të arsyeshme, në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme të:

a) marrëveshjes për zbatimin e nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT);

b) nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë;

c) Kreut III, të titullit II, të Kodit Doganor.

5. Rregullimet

Vlera doganore që bazohet në metodat 1 deri 6, rregullohet duke shtuar apo zbritur elementet e mëposhtme:

5.1 Elementet që shtohen:

Elementet e mposhtme, në masën që ato kanë qenë në ngarkim të blerësit, por nuk janë përfshirë në çmimin realisht të paguar ose që duhet paguar për mallrat, si:

a) shpenzimet e transportit dhe të sigurimit, ngarkimit apo trajtimit lidhur me dërgimin e mallrave deri në kufi të Republikës të Shqipërisë;

b) komisionet dhe ndërmjetësit, përveç komisionit të blerjes;

c) pagesat për përdorimin e së drejtës të pronësisë intelektuale (*royalties* dhe e drejta e licencës);

d) vlera e përpjesëtuara e mallrave dhe shërbimeve të ofruara direkt ose indirekt pa pagesë ose me kosto të reduktuar nga blerësi, që përdoren për prodhimin dhe shitjen për eksport të mallrave të importuara për:

i) materiale, pjesë përbërëse, pjesë dhe artikuj të ngjashëm të trupëzuar në mallrat e importuara;

ii) vegla, matrica, kallëpe e artikuj të ngjashëm, të përdorur për prodhimin e mallrave të importuara;

iii) materiale të harxhuara gjatë prodhimit të mallrave të importuara;

e) kontejnerët dhe paketimi (kostoja e ambalazhimit, duke përfshirë punën dhe materialet; kostoja e mbajtësve të mallrave, të cilat për qëllime doganore trajtohen si një e tërë me mallrat në fjalë);

f) vlera e çdo pjesë të fitimit të ardhur nga rishitja, përdorimi apo tjetërsimi i mëvonshëm i mallrave që i kthehet drejtpërsëdrejti apo tërthorazi shitësit.

5.2 Elementet që përjashtohen:

Nuk përfshihen në vlerën doganore:

a) kostot e transportit pas hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) Aktivitetet e marketingut të ndërmarra nga blerësi për llogari të tij.

c) Pagesat për komisionin e blerjes.

d) Pagesat e interesit që rrjedh nga një marrëveshje financiare e lidhur nga blerësi dhe që lidhet me porositjen e mallrave të importuara, pavarësisht nëse financimi mund të jetë bërë nga vetë shitësi ose nga një person tjetër, me kusht që marrëveshja të jetë me shkrim dhe, kur kërkohet, blerësi të jetë në gjendje të vërtetojë se: këto mallra janë shitur realisht me çmimet e deklaruara dhe se norma e interesit të pretenduar nuk e kalon nivelin e normës për transaksione të tilla që mbizotëron në vendin dhe kohën kur është siguruar financimi.

e) Shpenzimet për të drejtën e riprodhimit në Republikën e Shqipërisë të mallrave të importuara.

f) Shpenzimet për ndërtimin, ngritjen, montimin, mirëmbajtjen ose asistencën teknike, të ndërmarra pas hyrjes në territorin doganor të Republikës të Shqipërisë të mallrave të importuara, si komplekse industriale, makineri, pajisje.



g) Detyrimet dhe taksat e importit dhe pagesa të tjera që duhen paguar në Republikën e Shqipërisë për arsye të importit apo shitjes së mallrave.

6. Dokumentacioni shoqërues që lidhet me vlerën doganore

Shqyrtimi i vlerës doganore bazohet në shqyrtimin e dokumentacionit shoqërues të DAV-it, si:

a) Fatura tregtare apo çdo dokument i barasvlershëm me të (për shembull, kontratë për blerje automjeti etj.);

b) Faturë transporti (kur transporti nuk përfshihet në faturën tregtare);

c) Dokumentacioni i sigurimit të mallit (nëse ka);

d) Certifikata e cilësisë (ose dokumentacion tjetër të ngjashëm);

e) Certifikata e origjinës së mallit (nëse ka).

7. Profilizimi i riskut në vlerësimin doganor

Indikatorët që mund të evidentojnë një shqyrtim më të thelluar të vlerës doganore, mund të jenë:

- Historiku i shkeljeve doganore, rastet, natyra e tyre.

- Ekziston një ndryshim i dukshëm midis vlerës së deklaruar dhe çmimeve të *Database*-it Kombëtar të Vlerësimit apo të të dhënave të disponueshme për artikujt që përditësohen nga bursat apo agjenci ndërkombëtare.

- Vlera e mallrave është deklaruar në bazë të “faturave pro-forma” ose faturat me vlerat vetëm për qëllime doganore.

- Ka indikacione për një marrëdhënie ndërmjet furnizuesit dhe operatorit.

- Ka çmime të ndryshme të deklaruara për të njëjtin produkt, nga furnizues/origjina të njëjta/ngjashme.

- Vendi i origjinës/lëvrimin me risk: Azisë, Lindjes së Largët, vendeve arabe, zonave të lira (zona *off-shore*), Amerika Latine.

- Vendi i origjinës ndryshon nga vendi nga ku transportohet/lëvrohet malli.

- Përmbajtja e faturave nga i njëjti furnizues paraqet luhatje jo të zakonshme.

- Përfshihen shitjet e njëpasnjëshme (zinxhir shitjesh).

- Ekziston një tregtar ose një kompani e tretë (agjenti blerës) i përfshirë në transaksione.

- Mallrat vijnë nga një vend pa marrëveshje të asistencës reciproke me vendin tonë ose nga ku

është e vështirë për të marrë informacion.

- Pagesat nuk bëhen direkt për furnizuesin nga operatori ekonomik.

- Vendi i ngarkimit nuk korrespondon me vendin e adresën e eksportuesit.

- Ekziston një ndryshim i dukshëm midis çmimit të deklaruar me çmimet nga publikime në tregje të ndryshme.

- Vlera e produktit nuk mund të jetë më e ulët se vlera e lëndës së parë me të cilën është prodhuar.

- Indikatorë të tjerë të paspecifikuar më lart etj.

8. Dokumentacioni shtesë

Kur ka dyshime mbi vërtetësinë e transaksionit, kërkohen nga deklaruesi sqarime dhe dokumentacion shtesë në mbështetje të transaksionit, si:

a) *Kontrata e shitjes*, e cila mund të përdoret në mbështetje të aspekteve të ndryshme të faturës, të tilla si:

i) ndonjë kufizim i mundshëm, kusht ose konsideratë;

ii) çdo marrëveshje e mundshme midis shitësit dhe blerësit që ndikojnë në vlerën doganore të mallrave;

iii) pagesat e përmendura për aktivitetet e ndërmarra pas importimit;

iv) monedhën në të cilën është vendosur një çmim;

v) kontratat dhe dokumentet e tjera lidhur me të drejtat e prodhimit për mallrat e importuara;

b) Dokumentacioni i kryerjes së pagesës.

c) Kontrata e pronësisë intelektuale; shërben për të përcaktuar nëse është apo jo një pagesë pronësia intelektuale, duhet të përfshihet në vlerën doganore dhe, nëse po, deri në çfarë mase të përcaktuar.

ç) Kontrata për komisionet; shërben për të përcaktuar shtesa apo pakësime për t'u përfshirë apo zbritur nga vlera doganore.

d) Dokumente të transportit për:

i) kushtet e transportit;

ii) kostot e transportit deri në vendin e hyrjes;

iii) shpenzimet e ngarkimit dhe trajtimit që lidhen me transportin e mallrat të importuara;

iv) shpenzimet e transportit, pas mbërritjes në vendin e hyrjes.

dh) Dokumentacion që lidhet me shpenzimet për sigurimin e mallrave të importuara.

e) Dokumente të tjera:

i) në lidhje me pronësinë e kompanive të përfshira në transaksion, për të verifikuar marrëdhënien ndërmjet shitësit dhe blerësit;



ii) kontratë shitje dhe dokumentacion për transferim të pagesave;

iii) certifikatat e origjinës, cilësisë, fito-sanitare, veterinarë etj.;

iv) kontratat për reklama, marketing dhe veprimtari të tjera të ndërmarra pas importimit;

v) dokumentet financiare, për shembull, për përcaktimin e shumës së pagesave të interesit;

vi) kontratat, marrëveshjet e licencimit apo dokumente të tjera në lidhje me të drejtat e autorit;

vii) kur është e mundur, deklaratën e eksportit.

f) Të dhënat e kontabilitetit të kompanisë.

g) Të dhëna të tjera.

9. Pranimi transaksionit

Kur nga shqyrtimi i dokumentacionit, rrethanave në të cilat është kryer transaksioni dhe profilizimit të riskut, nuk ka dyshime dhe dokumentacioni kryesor sipas pikës 6 të këtij udhëzimi është i plotë dhe pa mangësi, pranohet vlera e transaksionit dhe mbi këtë bazë llogariten detyrimet doganore.

10. Përdorimi i metodave të tjera

Kur nga shqyrtimi i dokumentacionit, rrethanave në të cilat është kryer transaksioni dhe profilizimi i riskut ka dyshime, kërkohet dhe shqyrtohet dokumentacioni shtesë dhe:

a) Autoritetet doganore, përpara se të marrin një vendim përfundimtar, duhet të sqarojnë personin e interesuar për arsyet që çojnë në dyshime.

b) Në mbështetje të kërkesës së importuesit, autoritetet doganore duhet të njoftojnë me shkrim vlerësimin doganor për çdo artikull, si dhe metodën e përdorur.

c) Kur pas dyshimeve të lindura nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqëruar dhe pas sqarimeve dhe informacioneve shtesë të vëna në dispozicion nga importuesi, përsëri nuk justifikohet plotësisht vlera e transaksionit, atëherë për vlerësimin e mallrave në fjalë përdoret, sipas radhës, metoda e vlerësimit, duke ndalur te metoda më e parë për të cilën ka të dhëna të mjaftueshme, bazuar këto në transaksione të pranuar më parë, të përfshira në *Database-in* Kombëtar të Vlerësimit etj.

d) Në rastet kur nuk është e mundur që çmimi i mallit të përcaktohet sipas metodave 1-5, atëherë për vlerësimin e mallit përdoret metoda 6 e vlerësimit doganor.

e) Kur njësi matëse e mallit në faturë nuk korrespondon me atë të shprehur në *Database-in*

Kombëtar të Vlerësimit, doganieri mund t'u referohet njërive që mundësojnë krahasueshmërinë e tyre.

f) Në rastet kur për ndonjë artikull nuk disponohet asnjë e dhënë për nivelin e çmimeve, nga dega doganore apo strukturat e posaçme¹, ngrihet “grup vlerësimi”, i cili harton një procesverbal me argumentet përkatëse për çmimin që vendosin. Për këtë rivlerësim vihet në dijeni me shkrim departamenti teknik.

g) Kur mallrat e importuara janë dërgesë e pjeshme e një produkti, vlera e tyre llogaritet në mënyrë përpjesëtimore.

h) Kur importohen mallra të përdorura dhe transaksioni i paraqitur nuk justifikon gjendjen e tyre, nga dega doganore apo strukturat e posaçme, ngrihet “grup vlerësimi”, që merr në konsideratë sipas rastit, vitin e prodhimit, shkallën e amortizimit, gjendjen reale të tyre etj., por jo më pak se 40% të vlerës të mallit të ri.

i) Kur ka dyshime për transaksionin dhe rrethanat nuk e mundësojnë mbylljen e procesit të vlerësimit, nga doganieri kërkohet ngritja e një “grupi vlerësimi”.

j) Strukturat të ndryshme doganore, kontrolluese, mbikëqyrëse ose monitoruese, të cilave gjatë ushtrimit të detyrës u lindin dyshime të arsyeshme për vlerën doganore, i kërkojnë zyrtarisht degës doganore apo strukturave përkatëse rishqyrtim të praktikave.

k) Bazuar në analizën e riskut, strukturat e ngarkuara, kryejnë kontrole për vlerësimin e mallrave edhe pas zhdoganimit.

l) Pas kontrollit të vlerës, në faqen informuese të deklarimit doganor në sistemin elektronik *Ajycuda* duhet të sqarohet:

- Arsyet e refuzimit të transaksionit;

- Argumentimi i metodës së vlerësimit të përdorur;

- Detaje mbi shtesat/pakësimet e bëra në vlerën doganore sipas pikave 5.1 dhe 5.2;

- Komentet e tjera.

11. Përdorimi i “Database-it të vlerësimit”

Database-i Kombëtar i Vlerësimit është një instrument funksional në procedurën e analizës së riskut dhe vlerësimit doganor. Të dhënat e këtij *database-i* përmbajnë vlera ose çmime të pranuar

¹ Struktura e posaçme është Njësia Qendrore e Vlerësimit.



nga autoritetet doganore gjatë procesit të zhdoganimit. Kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme procedohet sipas pikës 10 (c). Këto të dhëna mund të shfrytëzohen edhe nga struktura të tjera të kontrollit dhe monitorimit të vlerës doganore, nëpërmjet sistemit elektronik. Ky instrument mbështetet në rekomandimet dhe udhëzimet e Organizatës Botërore të Doganave.

12. Plotësimi i deklaratës së vlerës doganore

Strukturat e kontrollit dokumentar, në zbatim të nenit 169 të VKM-së nr. 651, datë 10.11.2017, (Dispozitat zbatuese), kërkojnë plotësimin e formularit me të dhëna përkatëse në lidhje me vlerën doganore.

13. Dalja nga regjimet e magazinimit

Për mallrat që futen në magazinim (në magazinë doganore dhe në magazinim të përkohshëm) kur nga autoriteti doganor transaksioni nuk pranohet, si moment referimi për vlerësimin për qëllime doganor do të merret ai i hyrjes në magazinim. Kur në magazinimin (magazinë doganore apo magazinim i përkohshëm) ndodh një zinxhir shitblerjesh, për qëllime të vlerësimit doganor të mallrave, autoriteti doganor nuk mund të pranojë një vlerë në ulje.

14. Verifikime

Kur për vlerën e deklaruar ka dyshime të arsyeshme, autoritetet doganore mund t'i dërgojnë praktikën e plotë për verifikim pranë Departamentit Operativ Hetimor për verifikime të thelluara, të mëtejshme, brenda dhe jashtë vendit. Për çdo rast, autoritetet doganore duhet të argumentojnë dyshimet dhe korrespondencën përkatëse me subjektin, shoqëruar me vlerësimin doganor.

Nëse pas verifikimeve të kryera rezultojnë parregullsi, Departamenti Operativ Hetimor me strukturat e tij ose në bashkëpunim, mbështetur në dispozitat ligjore, vijon punën për rikuperimin e borxhit të krijuar dhe rregullimin e situatës, duke përfshirë marrjen e të gjitha masave përkatëse dhe penalizimit për kundërvajtjet administrative ose penale. Gjithashtu, për këto raste vihet në dijeni edhe departamenti teknik.

15. Burimet e informacionit të “Dosjes me të dhëna të disponueshme” dhe miratimin e tyre

15.1 Si burim informacioni për krijimin e dosjes me “Të dhënat e disponueshme” shërbejnë burimet e përcaktuara më poshtë:

a) Çmimet e tregjeve ndërkombëtare, të marra nga agjencia ndërkombëtare “Thomson-Reuters”;

b) Çmimet e tregjeve ndërkombëtare të marra nga agjencia ndërkombëtare “Platts”;

c) Buletine të tjera zyrtare ndërkombëtare, që mund të përdoren për vlerësimin doganor të çmimeve të çeliqueve, si “Metal Bulletin”, “Steel Week”;

d) Fatura të konfirmuara nga Departamenti Operativ Hetimor (DOH), marrëveshjet me homologët doganorë;

e) Çmime të publikuara në Eurostat dhe Organizata Botërore e Tregtisë (OBT);

f) Buletine të çmimeve të automjeteve dhe pjesëve të këmbimit, si:

g) “Quattroroute”, “Tuttotransporti”, “Schwackeliste” dhe “Tec-Doc”;

g) Të dhëna statistikore të nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

h) Portale dhe publikimi nga interneti etj. (portale që publikojnë çmime, të dhëna dhe studime të tendencave të tyre).

15.2 Përgatitja dhe përditësimi i të “Dhënave të disponueshme” bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe miratohen nga Komisioni *Ad-Hoc* në varësi të ministrit të Financave.

15.3 Për artikujt që sigurohen informacione nga burimet e përmendura në pikën 15.1, gjerat “a”, “b”, “c”, dh”, vendosja dhe rishikimi i çmimeve në “dosjen me të dhëna të disponueshme”, bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme të Doganave pa kaluar për miratim në Komisionin *Ad-Hoc*.

16. Afatet e përditësimit

16.1 Për artikujt e karburanteve të tilla, si: benzinë, gazoil, mazut, solar, vajgur, jet, gaz i lëngshëm (butan, propan), biodiesel (dhe të gjitha nënproduktet), Drejtoria e Vlerës Doganore harton shkresën me çmimet e përditësuara dhe pas firmosjes nga titullarët e institucionit ua dërgon degëve doganore dhe strukturave të tjera që ju nevojitet ky informacion. Përditësimi i këtyre artikujve është çdo ditë pune.

16.2 Për artikujt grurë, misër, oriz, sheqer, vaj ushqimor, produktet e çelikut, plehrat kimike, Drejtoria e Vlerës harton shkresën dhe, pas firmosjes nga titullarët e institucionit, dërgohet në degët doganore. Afati i përditësimit është çdo 2 javë (fillim dhe mes muaji).

16.3 Drejtoria e Vlerës Doganore në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave bën propozime për



përditësime të mallrave të ndryshme, që nuk përfshihen në pikat 15.1 dhe 15.2, sa herë siguron informacione të nevojshme.

17. Zhdoganimi i automjeteve

17.1 Për zhdoganimin e automjeteve, në rastet kur nuk pranohet transaksioni dhe nuk është i mundur përdorimi i metodave të tjera, vlerësimi bazohet në publikimet e buletineve “Quattroroute”, “Tuttotrasporti”, “Schwackeliste” etj., që pasqyrojnë çmimet e shitjes në tregjet europiane.

17.2 Vlera e një autoveture gjendet në tabelën “Quattroroute”, duke u nisur nga marka, modeli dhe viti i prodhimit. Në këtë rast, vlera e automjetit nuk duhet të jetë më e ulët se 80% e çmimit që gjendet në tabelë.

17.3 Kur për autoveturën që vlerësohet nuk gjendet të dhëna në buletin, vlerësimi bazohet duke u nisur nga modeli dhe cilindrata më e afërt. Në këtë rast, vlera nuk duhet të jetë më e ulët se 80% e çmimit që jepet në buletin.

17.4 Vlera për kamionçina, furgona dhe kamionë gjendet në publikimet e revistës “Tuttotrasporti”, duke u nisur nga marka, modeli dhe viti i prodhimit. Në këtë rast, vlera doganore nuk duhet të jetë më e ulët se 80% e çmimit të gjendur në tabelë.

Vlerësimi i automjeteve me vit prodhimi para vitit të fundit të publikuar në buletin, nuk mund të llogaritet më pak se çmimet e pasqyruara si më poshtë vijon:

Për autoveturat	Çmimet
a) Deri 1400 cc jo më pak se	130.000 lekë
b) Mbi 1400-1900 cc jo më pak se	200.000 lekë
c) Mbi 1900-2500 cc jo më pak se	325.000 lekë
d) Mbi 2500-3000 cc jo më pak se	400.000 lekë
e) Mbi 3000-4500 cc jo më pak se	500.000 lekë
f) Mbi 4500 cc jo më pak se	800.000 lekë

Kamionçina, furgona dhe kamionë	Çmimet
a) Deri në 1.5 tonë jo më pak se	400.000 lekë
b) Nga 1.5 tonë deri në 3.5 tonë jo më pak se	600.000 lekë
c) Nga 3.5 tonë deri në 10 tonë jo më pak se	850.000 lekë
d) Nga 10 tonë deri në 15 tonë jo më pak se	1.000.000 lekë
e) Mbi 15 tonë jo më pak se	1.200.000 lekë

18. Zhdoganimi i pjesëve të këmbimit për automjete

18.2 Për zhdoganimin e pjesëve të automjeteve, në rastet kur nuk pranohet transaksioni dhe nuk është e mundur përdorimi i metodave të tjera, vlerësimi bazohet në publikimet e katalogut elektronik “Tec-doc”.

18.3 Në vartësi të fluksit të importeve dhe mundësisë së instalimit të katalogut elektronik “Tec-doc”, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave përcakton degën/degët doganore apo strukturë tjetër e posaçme për kryerjen e procedurave të zhdoganimit.

18.4 Fatura e paraqitur për zhdoganim duhet të pasqyrojë numrin identifikues të artikullit. Kur fatura nuk e përmban këtë element, duhet t’i kërkohet subjektit depozitimi i një dokumenti, ku të identifikohet çdo artikull me kodin identifikues të tij.

18.5 Burimi i informacionit janë të dhënat e buletinit “Tec-doc”, të përcaktuar në shkronjën “e” të pikës 9.1 të këtij udhëzimi.

18.6 Për çdo artikull që zhdoganohet, futet kodi në programin e instaluar për këtë qëllim dhe aplikohet një ulje deri në 80% ndaj vlerës së gjetur.

18.7 Vlera që rezulton pas zbritjes duhet të shërbejë për doganierët e vlerësimit si një indikator i rëndësishëm krahasimi me çmimin e deklaruar.

18.8 Kur çmimi i faturës është poshtë kësaj vlere, atëherë ky fakt mund të shërbejë për rivlerësimin e mallit të deklaruar.

18.9 Kur mallrat nuk janë të identifikueshme, sipas metodës së mësipërme, për vlerësim përdoret një nga metodat alternative të vlerësimit të parashikuara në Kodin Doganor.

19. Përditësimi i kursit të këmbimit

Në rastet kur faturat e importit paraqiten në monedha të cilat nuk përfshihen në listën e monedha të huaja që publikohen nga Banka e Shqipërisë, Autoriteti Doganor Shqiptar do të kërkojë nga Banka e Shqipërisë kuotimin e kësaj monedhe të huaj në monedhën kombëtare. Në rast të një përgjigjeje negative (apo mospërgjigjeje) do të merren të dhëna nëpërmjet internetit të kuotimit të kësaj monedhe në monedha të tjera të huaja, si USD apo EURO.

20. Informacioni i detyrueshëm mbi vlerësimin doganor

Punonjësit e doganës që kryejnë vlerësimin apo rivlerësimin për qëllime doganore të mallrave të



ndryshme, duhet të shprehen qartë dhe në formë shtjelluese në faqen informuese të DAV-it në sistemin *Ajycuda*, si në rastin e pranimin të transaksionit edhe në rastet e refuzimit të tij, duke renditur argumente mbështetëse për mënyrën e vlerësimit doganor të përdorur.

21. Zbatimi

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe strukturat e saj për zbatimin e këtij udhëzimi dhe propozime për shtesa apo ndryshime kur konsiderohen.

22. Shfuqizime

- Udhëzimi i ministrit të Financave nr. 25, datë 30.11.2007, “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Udhëzimet dhe urdhrat e Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave lidhur me vlerësimin doganor:

- Udhëzimi nr. 6, datë 8.10.1999, “Mbi organizimin e grupit të vlerësimit doganor”, shfuqizohet.

- Udhëzimi nr. 6/1, datë 9.12.1999, “Mbi disa probleme që lidhen me vlerësimin doganor”, shfuqizohet.

- Udhëzimi nr. 6/2, datë 20.12.1999, “Mbi mënyrën e përdorimit të Dosjes së Referimit të Vlerës”, shfuqizohet.

- Udhëzimi nr. 2, datë 24.5.1999, “Vlera e mallrave për qëllime doganore”, i ndryshuar, shfuqizohet.

- Udhëzimi nr. 1, datë 25.1.2006, “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, shfuqizohet.

- Udhëzimi nr. 1/1, datë 27.1.2006, “Burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të Dosjes me të Dhëna të Disponueshme”, shfuqizohet.

- Udhëzimi nr. 1/2, datë 27.2.2006, “Mbi zhdoganimin e pjesëve të këmbimit për automjete”, shfuqizohet.

- Udhëzimi nr. 1/3, datë 19.4.2006, “Mbi zhdoganimin e automjeteve”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë